

ÇELËSI TESTI PROFESIONAL

E DREJTË PENALE

TEZA 26

- 1. Shprehuni lidhur me konceptin penal te Marrëveshjes. Si e kuptoni atë për sa lidhet me bashkëpunimin, por edhe në dispozita të Pjesës së Posaçme. Jepni shembuj te saj në një veprë penale te posaçme dhe si qëndron ajo ne raport me veprën e kryer? (10 Pikë)**

Koncepti penal i marrëveshjes lidhet me bashkimin e vullneteve të dy ose më shumë personave për realizimin e një veprë penale dhe përbën një element thelbësor në analizën e bashkëpunimit në të drejtën penale. Në këtë kuptim, marrëveshja shfaqet si baza mbi të cilën ndërtohet bashkautorësia, duke reflektuar unitetin e qëllimit dhe koordinimin e veprimeve midis subjekteve, pavarësisht nëse ajo është e shprehur apo e nënkuptuar nga rrethanat faktike.

Në kuadër të bashkëpunimit, marrëveshja nuk është e mjaftueshme në vetvete për përgjegjësi penale, pasi kërkohet që vepra penale të kryhet të paktën në fazën e tentativës. Ajo shërben si elementi lidhës midis bashkëpunëtorëve dhe si tregues i një veprimtarie të përbashkët kriminale, por nuk përbën vetë figurë të pavarur penale në këtë rast.

Ndryshe paraqitet situata në disa dispozita të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, ku marrëveshja merr një rol autonom dhe mund të përbëjë vetë elementin konsumues të veprës penale. Në këto raste, ligjvënësi ka zgjedhur të penalizojë që në fazë të hershme rrezikun që paraqet koordinimi i qëllimeve kriminale. Kjo vërehet, ndër të tjera, në rastet e organizatave kriminale apo grupeve të strukturuar kriminale, ku ekzistenca e marrëveshjes për kryerjen e veprave penale është thelbësore për vetë figurën e veprës.

Në këtë mënyrë, marrëveshja në të drejtën penale paraqet një natyrë të dyfishtë: nga njëra anë si element subjektiv që mundëson bashkëpunimin dhe kërkon realizimin e mëtejshëm të veprës penale, dhe nga ana tjetër si element i pavarur që në disa raste mjafton për të konsumuar vetë veprën penale. Në kuadër të bashkëpunimit, marrëveshja nuk është e mjaftueshme në vetvete, pasi kërkohet edhe kryerja e veprës penale, të paktën në fazën e tentativës. Ndërsa në disa vepra të posaçme, ajo është e mjaftueshme për konsumimin e veprës penale, duke u konsideruar si element përbërës i saj. Kështu, për shembull, në veprën penale "Organizata Terroriste" parashikuar nga neni 234/a i Kodit Penal, marrëveshja midis personave për krijimin ose pjesëmarrjen në organizatën terroriste është e mjaftueshme për konsumimin e kësaj veprë, pa qenë e nevojshme fillimi i ekzekutimit të një veprë me qëllime terroriste, për shkak të rrezikshmërisë së lartë shoqërore që paraqet. Për rrjedhojë, marrëveshja mund të paraqitet herë si një fazë përgatitore në funksion të realizimit të veprës penale, dhe herë si vetë vepra penale, në varësi të mënyrës se si është parashikuar nga ligjvënësi penal.



2. Neni 259 i Kodit Penal, Korrupsioni pasiv i Personave që Ushtrojnë Funksione Publike, përmban "*...kërkimi...drejtpërdrejtë...i çdo lloj përfitimi...*", ndërsa neni 248 i Kodit Penal përmban "*...kur i kanë sjellë atij...përfitime materiale...të padrejta*". Bëni krahasimin ndërmjet elementeve penale të mësipërme parë në situata konkrete prej jush. (12 pikë)

Krahasimi ndërmjet nenit 259 dhe nenit 248 të Kodit Penal, në raport me elementet "*kërkimi...drejtpërdrejtë...i çdo lloj përfitimi*" dhe "*kur i kanë sjellë atij...përfitime materiale të padrejta*", duhet të fokusohet në natyrën juridike të përfitimit, mënyrën e realizimit të tij dhe rolin që ai luan në strukturën e veprës penale.

Në nenin 259 të Kodit Penal, elementi "kërkimi" tregon se vepra penale mund të konsumohet që në momentin kur funksionari publik shfaq vullnetin për të përfituar, pa qenë e nevojshme realizimi konkret i përfitimit. Termi "drejtpërdrejtë" tregon mënyrën e realizimit të këtij kërkimi ose marrjeje, duke përfshirë çdo formë komunikimi. Ndërsa shprehja "çdo lloj përfitimi" ka një shtrirje të gjerë dhe përfshin jo vetëm përfitime materiale, por edhe jomateriale, duke e zgjeruar ndjeshëm fushën e zbatimit të kësaj vepre penale. Në këtë kuptim, përfitimi përbën objektin e drejtpërdrejtë të marrëdhënies korruptive dhe është i lidhur me një raport shkëmbimi me ushtrimin e funksionit publik.

Në nenin 248 të Kodit Penal, përkundrazi, formulimi "kur i kanë sjellë atij...përfitime materiale të padrejta" tregon se përfitimi nuk është element që kërkohet apo negociohet, por një pasojë që rrjedh nga ushtrimi i paligjshëm i detyrës. Këtu kemi të bëjmë vetëm me "përfitime materiale", çka kufizon natyrën e përfitimit në krahasim me nenin 259 të Kodit Penal. Gjithashtu, kërkohet që këto përfitime të jenë "të padrejta", pra në kundërshtim me ligjin, dhe të jenë sjellë si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme të funksionarit. Në këtë rast mungon elementi i "kërkimit" apo i një marrëdhënieje shkëmbimi; përfitimi është rezultat i sjelljes së paligjshme dhe jo qëllim i artikulluar paraprakisht në formë marrëveshjeje.

Në një situatë konkrete, nëse një funksionar publik i kërkon një subjekti një shumë parash apo një favor tjetër për të kryer një veprim në detyrë, kemi rast tipik të nenit 259 i Kodit Penal, edhe nëse përfitimi nuk realizohet. Ndërsa nëse një funksionar, pa kërkuar apo negociuar asgjë, shkel ligjin dhe si pasojë përfiton materialisht në mënyrë të padrejtë, kemi rast të nenit 248 i Kodit Penal.

3. Argumentoni në përgjigjen tuaj, vendimin/kërkesën, si do të kualifikoni veprimin e një personi që ka lëvizur nga vendi i ngjarjes një kufomë duke e fshehur dhe e zhveshur atë për t'i marrë sendet personale, rrobat etj., sepse mendon që kështu nuk do të zbulohet e vërteta rreth vrasjes së tij. A jemi përpara ... *kryerja e veprimeve duke...ndryshuar apo fshirë gjurmët e saj ose duke lëvizur ... një send ...*", neni 301 i Kodit Penal, veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës, apo nenit



303 të Kodit Penal, “Fshehja ose asgjësimi i kufomës” ngaqë përmban “ ... fshehja... e kufomës... e bërë për të ndihmuar autorin e krimit..”. (14 pikë)

Neni 301 i Kodit Penal parashikon përgjegjësi për çdo veprim që synon të pengojë zbulimin e së vërtetës, duke përfshirë ndër të tjera ndryshimin, fshirjen e gjurmëve apo lëvizjen e sendeve që lidhen me veprën penale. Këtu theksi vihet tek ndikimi në provë dhe tek qëllimi për të deformuar apo penguar procesin e zbulimit.

Nga ana tjetër, neni 303 i Kodit Penal kërkon elemente më specifike: fshehjen ose asgjësimin e kufomës, të kryer me qëllim për të ndihmuar autorin e krimit. Pra, përveç veprimit material (fshehja e kufomës), kërkohet edhe një element subjektiv i posaçëm: ndihma ndaj autorit.

Në rastin konkret, subjekti ka lëvizur dhe fshehur kufomën, si dhe e ka zhveshur atë për të marrë sende personale, me arsyetimin se kështu nuk do të zbulohet e vërteta rreth vrasjes. Kjo tregon qartë se qëllimi kryesor është pengimi i zbulimit të së vërtetës, pra një ndërhyrje në provë (gjurmë, pozicion i trupit, identifikim).

Megjithatë, duhet analizuar nëse ky qëllim përkon edhe me elementin e nenit 303 i Kodit Penal, pra “për të ndihmuar autorin e krimit”. Nëse nga rrethanat del se veprimet janë kryer për të mbrojtur autorin (edhe nëse nuk është i njëjti person), atëherë plotësohet edhe elementi subjektiv i nenit 303 i Kodit Penal dhe kemi aplikim të kësaj dispozite si normë më specifike. Nëse, përkundrazi, personi vepron thjesht për të fshehur ngjarjen pa një lidhje konkrete me ndihmën ndaj autorit, atëherë mungon elementi specifik i nenit 303 i Kodit Penal.

Në situatën e dhënë, formulimi “sepse mendon që kështu nuk do të zbulohet e vërteta rreth vrasjes” lidhet drejtpërdrejt me pengimin e zbulimit, pa u artikuluar domosdoshmërisht një qëllim për të ndihmuar autorin si të tillë. Për rrjedhojë, elementi subjektiv i nenit 303 i Kodit Penal nuk rezulton i plotë.

Si përfundim, kualifikimi më i saktë juridik është sipas nenit 301 të Kodit Penal, pasi veprimet e kryera përbëjnë ndërhyrje në gjurmët e veprës dhe synojnë pengimin e zbulimit të së vërtetës. Neni 303 i Kodit Penal do të ishte i zbatueshëm vetëm nëse provohet se fshehja e kufomës është bërë me qëllim të posaçëm për të ndihmuar autorin e krimit.

- 4. Analizoni situatën kur, Prokurori ka ngritur akuzë për vrasje, neni 78 i Kodit Penal dhe deklarata të rreme përpara prokurorit, neni 305/a i Kodit Penal. Akuza e dytë është ngritur ngaqë i akuzuari për vrasje ka gënjyer prokurorin përgjatë hetimeve që ka drejtuar. Kur i akuzuari është pyetur nga prokurori nuk ka pranuar të deklarojë me shkrim, por vetëm gojarisht. Mendoni se akuza e ngritur nga prokurori për nenin 305/a do të jetë e suksesshme në gjykim? (14 pikë)**

I pandehuri gëzon të drejtën të heshtë, të mos japë deklarime, por edhe të japë deklarime që nuk janë të vërteta, pa u ndëshkuar për këtë, për sa kohë këto deklarime lidhen me mbrojtjen e




tij. Ky parim buron nga e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe nga standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare (nemo tenetur se ipsum accusare).

Në rastin konkret, personi është i akuzuar për vrasje dhe deklaratat e tij (edhe nëse janë të pavërteta) janë dhënë në kuadër të mbrojtjes së vetes gjatë hetimit. Fakti që ai nuk ka pranuar të deklarojë me shkrim, por vetëm gojarisht, nuk ndryshon thelbin e situatës juridike, pasi statusi i tij si i pandehur mbetet i njëjtë dhe ai nuk ka detyrim për të thënë të vërtetën.

Për rrjedhojë, elementi penal i nenit 305/a i Kodit Penale nuk plotësohet në këtë rast, pasi mungon detyrimi ligjor për të dhënë deklaratime të vërteta nga ana e të pandehurit. Kjo dispozitë synon subjekte të tjera procedurale (si dëshmitarët), të cilët kanë detyrim për të thënë të vërtetën, dhe jo të pandehurin që ushtron të drejtën e mbrojtjes. Në këtë kuadër, paragrafi 2 i nenit 305/a i Kodit Penal e përjashton shprehimisht të pandehurin apo të dyshuarin nga përgjegjësia penale.

Si përfundim, akuza për deklaratat të rreme sipas nenit 305/a i Kodit Penal nuk pritet të jetë e suksesshme në gjykim, pasi bie ndesh me të drejtën e të pandehurit për të mos u vetëinkriminuar dhe për të ushtruar lirisht mbrojtjen e tij, edhe përmes mohimit apo dhënies së deklaratimeve të pavërteta.



Idlira Peci,

TESTI PROFESIONAL
ÇELËSI - PROCEDURA PENALE

TEZA 1

I. Pyetje mbi koncepte (10 pikë)

Në rastin e ekstradimit për jashtë shtetit zbatohet parimi i specialitetit. Cili është kuptimi i këtij parimi?

Në mbështetje të parimit të specialitetit në rastin e ekstradimit, i ekstraduari nuk do të ndiqet penalisht, nuk do të dënohet, nuk do t'i dorëzohet një shteti tjetër të ndryshëm nga shteti kërkuar, për një veprë penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga vepra penale për të cilën është dhënë ekstradimi. Kushtet e mësipërme nuk do të merren parasysh vetëm në dy raste:

1. Kur pala dorëzuese jep pëlqimin që i ekstraduari të ndiqet edhe për një veprë tjetër penale dhe i ekstraduari nuk ka kundërshtuar.
2. Kur i ekstraduari edhe pse ka pasur mundësi nuk e ka lënë territorin e shtetit tek i cili është dorëzuar pasi kanë kaluar 45 ditë nga lirimi i tij, ose pasi e ka lënë është kthyer vullnetarisht.

II. Pyetje krahasuese. (10 pikë)

Bëni dallimin midis dy rasteve të gjyqimit të drejtpërdrejtë.

Në rastin e parë prokurori paraqet në gjykatë brenda 48 orëve kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë bashkë me kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë, kur çmon se nuk ka nevojë për hetime të mëtejshme. Vepra penale për të cilën është arrestuar i dyshuari duhet të gjykohej nga një gjyqtar i vetëm. Kur arrestimi vleftësohet i ligjshëm dhe nuk ka nevojë për hetime shtesë, procedohet menjëherë në gjykim. Kur arrestimi në flagrancë nuk gjendet i bazuar, aktet i kthehen prokurorit. Në rastin e fundit, kur i pandehuri dhe prokurori japin pëlqimin, megjithëse arrestimi në flagrancë nuk gjendet i bazuar, gjykata procedon me gjykim të drejtpërdrejtë.

Rasti i dytë, i pandehuri është arrestuar sërish në flagrancë dhe arrestimi duhet të jetë vleftësuar i ligjshëm. Të pandehurit duhet t'i jetë caktuar masa e sigurimit e parashikuar nga nenet 237, 238 dhe 239 të KPP. Brenda 30 ditëve nga data e arrestimit, prokurori paraqet në gjykatë kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë kur hetimet janë të plota dhe nuk ka nevojë të kryhen hetime të mëtejshme.

III. Pyetje argumentuese (15 pikë)

Cili është kuptimi i parimit të prezumimit të pafajësisë në procedurën penale? Argumentoni lidhjen e tij me barrën e provës dhe me rregullin për çmuarjen e dyshimeve.



I pandehuri prezumohet i pafajshëm derisa nuk vërtetohet fajësia e tij me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Në këtë kuptim parimi i prezumimit të pafajësisë duhet të respektohet nga gjykata dhe prokuroria ndaj të pandehurit që në fillimet e nisjes së procedimit penal dhe deri në përfundimin e tij kur i pandehuri vërtetohet se është fajtor me anë të një vendimi të dhënë nga gjykata që duhet të jetë i formës së prerë. Në funksion të këtij parimi i pandehuri nuk ka asnjë detyrim ligjor që të provojë pafajësinë e tij në procesin penal, ai ka të drejtë të heshtë, të paraqesë lirisht mbrojtjen e tij si dhe të mos i përgjigjet pyetjeve të caktuara. Heshtja dhe e drejta e për tu mos vetë-inkriminuar janë garanci ligjore që nuk favorizojnë prokurorin në drejtim të vërtetimit të akuzës. Prokurorit i ngarkohet barra e provës në procesin penal që të provojë fajësinë e të pandehurit përtej dyshimeve, qofshin këto edhe dyshime të arsyeshme. Në procesin e të provuarit, të pandehurit nuk i ngarkohet asnjë barrë prove në drejtim të lehtësimit të pozitës së tij në lidhje me veprën penale të sjellë në gjykim. Çdo dyshim që lidhet me vërtetimin e akuzës së sjellë për gjykim çmohet në favor të të pandehurit. Dyshimi nuk është bazë e mjaftueshme për fajësinë e të pandehurit.

IV. Arsyetim analitik (15 pikë)

“P” është person që ushtron funksione publike. Ai u arrestua në flagrancë të krimit të parashikuar nga neni 259 i KP-së (Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike) nga policia gjyqësore e shërbimeve të Drejtorisë Vendore të Policisë në Elbasan. Gjkata e juridiksionit të përgjithshëm e atij rrethi caktoi ndaj tij masën e sigurimit “arrest në burg”.

1- Përveç caktimit të masës së sigurimit, çfarë duhet të disponojë në vendim ajo gjykatë në lidhje me kompetencën? (3 pikë)

Në vendimin e caktimit të masës së sigurimit, gjykata duhet të deklarojë moskompetencën e saj lëndore dhe aktet duhet t’ia dërgojë gjykatës kompetente që në këtë rast është Gjykata e Shkallës së Parë “kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”.

2- I lind ndonjë detyrim gjykatës kompetente në këtë rast? Cili? (6 pikë)

Gjkata kompetente, brenda 10 ditëve nga marrja e akteve procedurale të sjella nga gjykata jokompetente duhet të vendosë për masën e sigurimit që është caktuar më parë nga gjykata jokompetente. Nëse gjykata kompetente nuk vendos për masën e sigurimit brenda afatit 10 ditor, atëherë masa e sigurimit e caktuar nga gjykata jokompetente humbet efektin e saj.

3- Ç’mund të themi për provat tashmë të marra nga gjykata e juridiksionit të përgjithshëm? Ka ndonjë kufizim në përdorimin e tyre? (6 pikë)

Provat e marra në gjykatën e juridiksionit të përgjithshëm në seancën e caktimit të masës së sigurimit nuk i nënshtrohen asnjë kufizimi ligjor në përdorimin e tyre në gjykim në gjykatën kompetente. Mosrespektimi i dispozitave mbi kompetencën nuk sjell papërdorshmërinë e provave të marra.

Klodian Kereshev
[Signature]

TESTI PROFESIONAL

E DREJTË CIVILE

TEZA 10

I. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtëme:

a. Cilat janë dhe si interpretohen kushtet e përgjithëshme të një kontrate. (3 pikë)

Kushtet e përgjithëshme të kontratës, janë të përgatitura prej njëres palë kontraktuese, dhe kanë efekt ndaj palës tjetër, në qoftë se në momentin e përfundimit të kontratës kjo e fundit i ka njohur ose duhej t'i kishte njohur, duke treguar një përkujdesje të zakonshme.

Kushtet e përgjithëshme të kontratës interpretohen në dobi të palës tjetër, në rast se kanë qenë dhënë prej njëres nga palët kontraktuese dhe kur ka dyshim në lidhje me to.

b. Kur shpërdahet një fondacion ? (3 pikë)

Fondacioni është person juridik pa anëtarësi që ka për objekt arritjen e një qëllimi të ligjshëm me anë të destinimit të pasurisë në të mirë dhe interes të publikut. Fondacioni e fiton personalitetin juridik me regjistrimin e tij në gjykatë.

Shpërndarja e fondacionit ndodh kur konstatohen ose plotësohen një nga shkaqet ligjore të mëposhtëme:

- me vendim të organit më të lartë vendimmarrës të tij;
- kur është përmbushur qëllimi për të cilin u themelua ose kur qëllimi i tij nuk mund të përmbushet më;
- kur vërtetohet se fondacioni ka filluar të ushtrojë veprimtari të kundërligjshme;
- në raste të tjera të parashikuara me ligj si dhe
- me vendim gjyqsor, në rastet e parashikuara me ligj, me kërkesë të çdo themeluesi të tij, të organeve vendimmarrëse të fondacionit, si dhe të organeve kompetente shtetërore.

c. Cilat janë pasojat e pavlefshmërisë së një veprimi juridik. (4 pikë)

Veprimi juridik i pavlefshëm është i tillë që nga momenti i kryerjes së tij. Ndërsa veprimi juridik relativisht i pavlefshëm konsiderohet i vlefshëm derisa gjykata me kërkesën e të interesuarit e shpall atë të pavlefshëm.

Në veprimet juridike absolutisht të pavlefshme veprimi juridik konsiderohet nul, pra nuk mund të shkaktojë pasoja juridike që nga momenti që është kryer. Ndërsa në rastet e pavlefshmërisë relative veprimi mbetet pa fuqi nga momenti i konstatimit të shkakut të tij nga gjykata, duke u rregulluar prej kësaj të fundit pasojat që ai ka shkakuar deri në këtë moment.



Pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik zgjidhen sipas natyrës së veprimit juridik në rrugë gjyqësore. Rregullimi i këtyre pasojave bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në dispozitat e Kodit Civil, konkretisht, për pavlefshmërinë absolute neni 106 dhe për pavlefshmërinë relative neni 107 e vijues.

II. Cila janë dallimet midis dëmit pasuror dhe jo pasuror? Shpjegoni dy konceptet. (10 pikë)

Dëmi pasuror sjell si pasojë cenimin e pasurisë së të personit në kuptimin e ngushtë ekonomik, pra humbjen e pasurisë në mënyrë të paligjshme. Prandaj shpërblimi i dëmit pasuror ka për qëllim të rikthejë pasurinë e të dëmtuarve në gjendjen e mëparshme, duke riparuar/kompesuar diferencën e krijuar ndërmjet gjendjes ekonomike aktuale të tyre, me atë në të cilin do të ndodheshin nëse nuk vërtetohej fakti i paligjshëm. Përgjegjësia për shpërblimin e dëmit pasuror parashikohet nga neni 608 i Kodit Civil, sipas të cilit personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar

Dëmi jo pasuror, si një kategori e gjerë dhe gjithëpërfshirëse e dëmeve jashtëkontraktore, përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jo pasurore që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vlerësimi të drejtpërdrejtë ekonomik. Në sferën e dëmeve jo pasurore bëjnë pjesë: dëmi biologjik; dëmi moral dhe dëmi ekzistencial. Përgjegjësia për shpërblimin e dëmit pasuror parashikohet nga neni 625 i Kodit Civil, sipas të cilit, personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur, ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetit të tij ose është fyer kujtimi i një të vdekuri.

III. Cili është qëllimi i rezervës ligjore dhe si zgjidhen pasojat e cënimit të saj. (15 pikë)

Qëllimi i rezervës ligjore parashikuar nga neni 379 i Kodit Civil është që të mbrojë një kategori të caktuar subjektësh që thiren në trashgim nga disponimet testamentare të trashgimlënsit. Rezerva ligjore si e tillë është një kufizim i lirisë së testatorit për të disponuar pasurinë me testament nga njëra anë dhe e drejtë e një grupi trashëgimtarësh ligjorë nga ana tjetër që t'u garantohet detyrimisht pjesa e tyre e pasurisë trashëgimore.

Kuptimi i rezervës ligjore do të thotë se, testatori nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarët e tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim, si dhe trashëgimtarët e paaftë për punë në qoftë se këta thirren në trashëgim.

Insituti i rezervës ligjore që të sjellë pasojat e duhura juridike, duhet të plotësohen disa kushte.

Së pari: -Të ketë fëmijë të mitur të cilët nuk mund t'i përjashtojë nga trashëgimia ligjore për asnjë arsye, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar;

-Të ketë trashëgimtarë të tjerë të mitur të cilët trashëgojnë me zëvendësim (neni 361/2);

-Të ketë trashëgimtarë të paaftë për punë (neni 371);

-Të ketë persona të tjerë të paaftë për punë, të cilët të paktën 1 vit para vdekjes së trashëgimlënësit, bashkëjetonin me atë si anëtarë të familjes dhe në ngarkim të tij (neni 363).

Së dyti, që personat e përcaktuar në rrethin e trashëgimtarëve ligjorë të cilët testatori nuk mund t'i përjashtojë nga trashëgimia, si dhe personat e tjerë të paaftë për punë të jenë përfitues të rezervës ligjore, duhet të plotësojnë edhe dy kushte të tjera ligjore:

-Të mos jenë bërë apo shpallur të padenjë për të trashëguar dhe,

-Detyrimisht të jenë thirrur në trashëgim.

Mungesa, qoftë edhe një prej këtyre kushteve bën që ata të mos jenë "rezervatarë ligjorë"

Pasojat që vijnë nga cënimi rezervës ligjore zgjidhen duke përdorur si mjet mbrojtës padinë e kërkimit të trashëgimit (neni 349). Personat që tërheqin interesa nga cënimi i rezervës ligjore (paditësi) mund të drejtohen gjykatës me padi me objekt detyrimin për njohje trashëgimtar dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore dhe të pasurisë së fituar me anë të saj, ndaj atij që e posedon këtë pasuri (i padituri) duke u hequr si trashëgimtar për shkak të disponimit absolutisht apo pjesërisht të pavlefshëm të testamentit, qoftë edhe kur ky person (i padituri) e mban pasurinë në bazë të një dëshmie trashëgimie (trashëgimtari aparent). Gjykata kur vendos pranimin e padisë me këtë objekt dhe shkak ligjor, sipas rastit argumenton cënimin e rezervës ligjore duke konstatuar në arsyetimin e vendimit pavlefshmërinë e plotë apo të pjesëshme të testamentit dhe në dipozitivin e vendimit zgjidh pasojat përkatëse që janë shkatuar nga ky cënim.

IV. Analizoni situatën e mëposhtëme dhe përgjigjuni pyetjeve të shtruar. (15 pikë).

- A ka fituar të drejtën e pronësisë mbi apartamentin Blerësi B, ndonëse sendi nuk është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Nëse po, cili do të konsiderohet momenti i fitimit të pronësisë?

-Blerësi B, e ka fituar pronësinë mbi sendin e paluajtshëm apartament, sipas kontratës së shitjes së datës 1.3.2020, pamvarësisht se kjo e fundit (kontrata) nuk është e regjistruar në regjistrat e pasurisë së paluajtshme. Kjo për arsye se sipas të dhënave të situatës në analizë, kontrata e shitjes si një veprim juridik i dyanshëm i përmbush të gjitha kushtet e vlefshmërisë së saj.

Ky arsyetim bazohet edhe në konkluzionet e aritura nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues nr. 1/2009, sipas të cilit, që kontrata e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme dhe konkretisht që kontrata e shitblerjes si veprim juridik të jetë e vlefshme është e domosdoshme që përveç kritereve të përgjithëshme të vlefshmërisë së veprimit juridik parashikuara në nenin 79 të Kodit Civil, që janë zotesia për të vepruar e palëve; vullneti i brëndshëm i palëve në një veprim juridik i cili duhet të përputhet me shfaqjen e tij të jashtme si dhe forma e kërkuar nga ligji. Gjithashtu duhet që të plotësohen edhe kushtet e parashikuara në nenin 663 të Kodit Civil dhe konkretisht, pëlqimi i palëve; shkak i ligjshëm; objekti i kontratës të jetë i përcaktuar dhe i ligjshëm dhe forma e kërkuar ligjore.

Regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik (kontratës) nuk është një element i vlefshmërisë së tij dhe se mosregjistrimi i kontratës në regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk e bën atë të

ÇELËSI
TESTI PROFESIONAL
PROCEDURË CIVILE
TEZA 12

Pyetja 1:

- a) Shpjegoni çfarë mund të vendosë gjykata nëse, gjatë gjykimit pala që është e detyruar të parapaguajë shpenzimet gjyqësore për dëshmitarët nuk i paguan vullnetarisht ato?**

Rregulli është që shpenzimet për thirrjen e dëshmitarëve, përmbaruesit, ekspertëve, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend parapaguhet nga pala që i ka kërkuar.

Nëse gjykata ka pranuar kërkesën për thirrjen e dëshmitarit dhe pala që i është ngarkuar të paguajë këto shpenzime nuk pranon t'i paguajë vullnetarisht gjykata mund të vendosë sipas rastit:

- a) Ngarkimin për t'i paguar ato pala tjetër;
- b) Detyrimet të paguhen pjesërisht nga secila prej palëve.

Ky vendim i mësipërm i gjykatës në këtë rast përbën titull ekzekutiv dhe është menjëherë i ekzekutueshëm nga shërbimi përmbarimor.

- b) Krahasoni, duke nxjerrë të përbashkëtat dhe dallimet midis shpenzimeve gjyqësore të pagueshme për ekspertët dhe për dëshmitarët.**

- E përbashkëta në lidhje me shpenzimet gjyqësore të pagueshme për ekspertët dhe dëshmitarët e thirrur në gjyq është se të dy këta subjekte kanë të drejtë të marrin shpenzimet që kanë bërë për paraqitjen e tyre si dhe shpërblim për largimin e tyre nga vendi i punës.
- Dallimi midis tyre në lidhje me shpenzimet gjyqësore është se eksperti përveç se shpenzimeve e shpërblimeve të përmendura më sipër ka të drejtë të shpërblehet edhe për shërbimin e kryer (për ekspertimin ose aktin e ekspertimit).

Pyetja 2:

- a) Krahasoni vendimet që mund të nxjerrë gjykata, kur personat që marrin pjesë në gjykimin e çështjes, si dhe personat e tjerë që asistojnë në gjykim nuk u binden urdhrave të kryetarit të seancës gjyqësore, me vendimet që merr gjykata në rastet kur palët ose përfaqësuesit e tyre me vetëdije paraqesin kërkesa abuzive.**
- Është detyrë e kryetarit të seancës gjyqësore të kujdeset për mbajtjen e rregullit dhe të qetësisë në seancë.

Kur palët, personat e tretë, avokatët ose përfaqësuesit e tyre si dhe prokurori kur merr pjesë në gjykimin civil, nëse nuk u binden urdhrave të kryetarit të seancës dhe prishin rregullin dhe qetësinë e seancës, kryesuesi i seancës urdhëron largimin nga salla të këtyre personave.

- Kur avokatët e palëve ose prokurori nuk i binden urdhrave të kryetarit të seancës, pra nuk largohen nga gjykimi, kryetari i seancës (gjykata) vë në dijeni respektivisht: organin drejtues të prokurorisë ose këshillin drejtues të Dhomës së Avokatisë dhe kërkon prej tyre marrjen e masave disiplinore dhe mund ta shtyjë seancën gjyqësore derisa të caktohet një prokuror apo avokat i ri në këtë gjykim.
- Kur palët apo avokatët e tyre paraqesin me vetëdije kërkesa abuzive, gjykata në përfundim të gjyimit, përveç kur ligji parashikon ndryshe, vendos gjobitjen e përgjegjësit në shumën 50 000 – 100 000 lekë.

b) Shpjegoni procedurën për kundërshtimin e vendimeve të gjykatës për dënimin me gjobë të dhëna gjatë gjyimit për mosbindje të urdhrave të kryetarit të seancës gjyqësore.

Personat e dënuar me vendim të gjykatës me gjobë për mos bindje të urdhrave të kryetarit të gjykatës gjyqësore kanë të drejtë t'i paraqesin gjykatës që i ka dënuar kërkesë për heqjen e këtij detyrimi, duke treguar dhe shkaqet e kësaj kërkesë. Kjo gjykatë mund ta revokojë këtë dënim ose ta pakësojë atë ose të vendosë refuzimin e kësaj kërkesë.

Pyetja 3:

a) Analizoni karakteristikat dalluese të institutit të heqjes dorë nga ankimi në Gjykatën e Apelit, nga heqja dorë nga rekursi në Gjykatën e Lartë.

Heqja dorë nga ankimi në Gjykatën e Apelit mund të bëhet në çdo fazë të gjyimit të çështjes.

- Ndërsa heqja dorë nga rekursi në Gjykatën e Lartë nuk mund të bëhet në çdo fazë të gjyimit, por vetëm para se Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk janë tërhequr për vendim.
- Heqja dorë nga ankimi në apel mund të bëhet me shkrim ose me gojë në seancë gjyqësore, kurse heqja dorë nga rekursi në Gjykatën e Lartë duhet të bëhet vetëm me shkrim e nënshkruar nga vetë pala ose avokati i saj i pajisur me prokurë për këtë qëllim.

b) Analizoni karakteristikat dalluese të institutit të “heqjes dorë nga e drejta e padisë” nga “heqja dorë nga gjykimi i padisë”.

- Heqja dorë nga e drejta e padisë mund të bëhet në çdo fazë të gjyimit në fazë të parë, si dhe në Gjykatën e Apelit, ndërsa heqja dorë nga gjykimi i padisë mund të bëhet në çdo fazë të gjyimit, por vetëm në Gjykatën e shkallës së parë.

- Heqja dorë nga e drejta e padisë në shkallë të parë shkakton rrëzimin e padisë së paditësit dhe në këto raste paditësi nuk ka të drejtë të ngrejë përsëri po këtë padi.
Heqja dorë nga e drejta e padisë në Gjykatën e Apelit shkakton si rrjedhojë prishjen e vendimit në shkallë të parë dhe rrëzimin e padisë.
- Heqja dorë nga gjykimi i padisë sjell si rrjedhojë pushimin e gjykimit nëse i padituri e pranon atë ose kur i padituri ende nuk ka paraqitur deklaratën e mbrojtjes.

Pyetja 4:

- a) **Analizoni shprehjen: “Pavlefshmëria nuk mund të shpallet kur akti ka arritur qëllimin për të cilin është destinuar”.**

Sipas Kodit të Procedurës Civile aktet procedurale të cilat nuk kanë respektuar formën ose përmbajtjen e kërkuar shprehimisht nga ligji, mund të shpallen të pavlefshme.

Mosplotësimi i këtyre elementeve të aktit procedural civil nuk shkakton automatikisht pavlefshmërinë e aktit, mbase pavlefshmëria e këtij akti, i cili është me vese të formës ose të përmbajtjes, të caktuara shprehimisht nga ligji, mund të shpallet i pavlefshëm vetëm nëse nuk e ka arritur qëllimin për të cilin është destinuar. Qëllimi i aktit procedural është shumë i rëndësishëm, sepse në varësi të faktit nëse një akt e arrin qëllimin për të cilin është krijuar, ky akt nuk mund të shpallet i pavlefshëm. Rasti tipik është letërthirja për në gjyq, e cila ndonëse mund të jetë plotësuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit, nëse personi është paraqitur në gjykim, gjykata këtë akt nuk mund ta shpallë të pavlefshëm.

- b) **Argumentoni ndryshimin ndërmjet koncepteve “pavlefshmëri e veprimit juridik” dhe “pavlefshmëri e aktit procedural”.**


- Pavlefshmëria e aktit procedural nuk përcaktohet vetëm nga fakti se ai nuk përmban të gjithë elementet e formës dhe të përmbajtjes të cilat ligji i përcakton si elemente të vlefshmërisë së aktit, mbase pavlefshmëria e aktit është e lidhur edhe me qëllimin për të cilin ligji e ka caktuar atë. Nëse akti procedural ka të meta të formës dhe/ose të përmbajtjes, por qëllimi për të cilin ai është destinuar është arritur, gjykata nuk ka të drejtë ta shpallë atë të pavlefshëm.

Ndërsa, nëse veprimi juridik civil ka vese të formës dhe/ose të përmbajtjes, të cilat ligji i ka përcaktuar si elemente të vlefshmërisë së tij, nëse këto vese provohen gjatë gjykimit si të vërteta, gjykata në çdo rast është e detyruar të vendosë: konstatimin ose shpalljen e këtij veprimi juridik të pavlefshëm.

- Veprimi juridik absolutisht apo relativisht i pavlefshëm për efekt të ligjit, sipas llojit të pavlefshmërisë, do të konsiderohet sikur nuk është kryer asnjëherë, nul, kurse veprimi juridik relativisht i pavlefshëm do të quhet i pavlefshëm që nga çasti kur është kryer.

Ndërsa akti procedural civil absolutisht apo relativisht i pavlefshëm edhe kur gjykata e shpall apo e deklaron atë si të tillë gjykata si rregull, kur është e mundur ka të drejtë të urdhërojë kryerjen e veprimeve për ta bërë këtë akt të vlefshëm, duke pranuar ripërtëritjen e aktit pjesërisht ose plotësisht.

- Veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet asnjëherë i vlefshëm nga gjykata, ndërsa aktet procedurale civile mund të bëhen të vlefshme edhe gjatë gjykimit por edhe nëpërmjet shqyrtimit të ankimit nga gjykata më e lartë, e cila për shkak të pavlefshmërisë së një akti procedural civil e prish vendimin e shkallës së parë dhe e kthen çështjen për rigjykim nga e para, duke lejuar që këto akte të pavlefshme të bëhen rishtas të vlefshme. Kjo ndodh për shembull kur Gjykata e Apelit konstaton mosnjohimin e palëve për shkak të pavlefshmërisë së aktit procedural të njoftimeve ose pavlefshmërisë së procesverbalit të seancës gjyqësore dhe për këto shkaqe e prish dhe e kthen çështjen për gjykim nga e para.



**TESTI PROFESIONAL
E DREJTA FAMILJARE
TEZA 12**

Rubrika I Pyetje mbi koncepte 10 pikë

Jepni kuptimin lidhur me institutin e "Pushimit të gjykimit në procedurën e zgjidhjes së martesës"

Përgjigje:

1. Nëse KF ka rregullime procedurale, ato prevalojnë në raport me Kodin e Procedurës Civile. Vendimi i pushimit, edhe në rastet e zgjidhjes së martesës, është një vendim jopërfundimtar që nuk e zgjidh çështjen në themel por i jep fund procesit gjyqësor të filluar (0.5)
2. Në procedurën e zgjidhjes së martesës, pushimi i gjykimit lidhet kryesisht me palën paditëse. Të tilla raste janë mungesa në gjykim në seancën e pajtimit pa shkaqe të arsyeshme të paditësit apo për shkak të heqjes dorë nga gjykimi prej tij; nëse paraqitet me anë të përfaqësuesit, gjykata nuk e pushon gjykimin, por e shtyn për t'u paraqitur pala paditëse personalisht. (4.5); vdes njëri nga bashkëshortët gjatë procedurës së zgjidhjes së martesës. E drejta e padisë për zgjidhjen e martesës nuk u kalon trashëgimtarëve edhe nëse gjykimi ka filluar më parë (4.5).
3. Nuk ka pushim gjykimi të zgjidhjes së martesës nëse: nuk paraqitet i padituri, ndonëse ka pasur dijeni rregullisht; nëse pala e paditur ka paraqitur deklaratën e mbrojtjes dhe ka interes të ligjshëm për vazhdimin e gjykimit, nëse është pranuar që bashkë me gjykimin e padisë të zhvillohet edhe gjykimi i kundërpadisë së zgjidhjes së martesës (0.5).

Rubrika II Pyetje krahasuese 10 pikë

Krahasoni kuptimin e 'martesë pa shpallje' dhe 'ndërprerje e shpalljes së martesës.'

Përgjigje:

1. Janë dy institute të ndryshme por kanë të përbashkët efekte në lidhjen me shpalljen: martesës pa shpallje synon lidhjen e saj pa u bërë fare shpallja dhe pa e cenuar vlefshmërinë e saj (1), ndërprerja e shpalljes së martesës nuk efektikon shpalljen por ndërpret ecurinë e afatit të shpalljes përkohësisht. Sapo shkaqet sqarohen, shpallja vazhdon aty ku u ndërpre(1).
2. Autoritetet që përfshihen dhe marrin vendimin janë të ndryshme: Vetëm gjykata e vendos lejimin e lidhjes së martesës pa shpallje. Në këtë rast kërkesa paraqitet nga prokurori i vendit ku do të lidhet martesë që çmon se ka një shkak me rëndësi dhe ja paraqet kërkesën dhe shkaqet e mos shpalljes gjykatës për të bërë vlerësimin (2); Vetëm nga nëpunësi i gjendjes civile vendos për ndërprerjen e shpalljes së martesës (2)



3. Shkaqet dhe qëllimet janë të ndryshme: 'martesa pa shpallje' bëhet vetëm për shkaqe me rëndësi për mbrojtjen dhe sigurinë e bashkëshortëve të ardhshëm (2); 'ndërprerja e shpalljes së martesës' i jep kohë nëpunësit të gjendjes civile të plotësohen parregullsi të konstatuar në dokumentacion ose verifikimet me qëllim respektimin e kushteve ligjore për martesë brenda diskrecionit të nëpunësit të gjendjes civile (2)

Rubrika III Pyetje argumentuese 10 pikë

Drini është martuar me Bunën dhe nga kjo martesë ata kanë dy fëmijë të datëlindjes 1990 dhe datëlindjes 1999. Drini është larguar jashtë shtetit në 1997 dhe nuk ka pasur asnjë marrëdhënie me Bunën. Gjatë mungesës së tij Buna ka pasur marrëdhënie jashtëmartesore me Korabin. Kush ka të drejtë të kundërshtojë atësinë e prezumuar? A ka afate që parashkruajnë të drejtën?

Përgjigje:

1. Kundërshtimi i atësisë në këtë rast lidhet me rregullat për atësinë e prezumuar. Drini dhe Buna vijojnë të jenë të martuar edhe pas largimit të Drinit jashtë shtetit në 1997 dhe fëmijët e lindur gjatë martesës kanë për atë bashkëshortin e nënës (2)
2. Lidhur me të drejtën e kundërshtimit të atësisë së prezumuar dhe afatet e parashkrimit këtë të drejtë e ka:
 - a. Drini, por vetëm nëse nuk ka kaluar 1 vit, nga data që ai ka marrë dijeni për lindjen e fëmijës me datëlindje 1999. Rrethanat dhe kushtet nëse ka marrë ose jo dijeni dhe nëse ka kaluar ose jo afati 1 vjeçar vlerësohen nga gjykata dhe barra e provës mbi padijeninë i takon Drinit (3)
 - b. të dy fëmijët, tashmë madhorë, nëse vlerësojnë të kundërshtojnë që ati i tyre është bashkëshorti i nënës. Kjo e drejtë e padisë nuk parashkruhet (3).
 - c. Subjektet e tjera, si nëna e fëmijëve dhe Korabi nuk e kanë këtë të drejtë. Për nënën padia është parashkruar me kalimin e një 1 viti nga lindja e fëmijës. Korabi nuk e ka këtë të drejtë në asnjë rast lidhur me rregullimet e KF në situatën e kundërshtimit të prezumimit (2).

Rubrika IV Arsyetim analitik 20 pikë

- *Neni 36 i Kodit të Familjes parashikon se: "Martesa e lidhur nga bashkëshortët pa pasur qëllim për jetë të përbashkët si burrë e grua është e pavlefshme". A jemi përpara kushteve të pavlefshmërisë së martesës kur njëri nga bashkëshortët nuk ka qenë në dijeni të faktit që bashkëshorti tjetër nuk ka pasur për qëllim jetesën e përbashkët, por vetëm përfitimin e avantazheve që i vinin nga ky status? Çfarë roli luan "mashtrimi", i njërit bashkëshort, lidhur me shpalljen e pavlefshmërisë.*

- *A mundet gjykata kryesisht me kërkesë të palës tjetër të cilësojë që nuk jemi përpara kushteve të një martesë të simuluar dhe të vazhdojë gjykimin me padi për zgjidhjen e martesës. Po pala tjetër a mund të kërkojë me kundërpadi zgjidhjen e martesës sipas nenit 132 të Kodit të Familjes (Zgjidhja e martesës me kërkesën e njërit bashkëshort). Si do të veprojë gjykata në një rast të tillë?*
- *Çfarë kuptoni ju detyrimin për “jetesë të përbashkët” të parashikuar nga neni 55 i K.Familjes. A përbën gjithmonë mungesa e jetesës së përbashkët në të njëjtën banesë, shkak për pavlefshmërinë e martesës.*

Përgjigje:

1. Pavlefshmëria e martesës lidhet me vese të aktit; zgjidhja e martesës lidhet me martesën juridikisht të vlefshme por që ka prodhuar marrëdhënie e cila kërkon zgjidhjen e saj (2).
2. Nga formulimi i nenit jemi përpara një rasti të pavlefshmërisë absolute të martesës. Kjo përforcohet edhe nga fakti se për këtë situatë padia mund të ngrihet edhe pas zgjidhjes së martesës dhe legjitimon secilin nga bashkëshortët, prokurorin dhe kushdo tjetër që ka një interes të drejtpërdrejtë të ligjshëm (3).
3. Në të drejten familjare pavlefshmëria e martesës ndodh edhe kur njëri nga bashkëshortët nuk ka qenë në dijeni të faktit që bashkëshorti tjetër nuk ka pasur për qëllim jetesën e përbashkët, por vetëm përfitimin e avantazheve që i vinin nga ky status. Këtë e përforcon edhe rregulli se për bashkëshortin që nuk ka ditur shkakun e pavlefshmërisë së martesës, pra që është ‘mashtuar’, pasojat fillojnë nga data që vendimi merr formë të prerë. Pra, legjislatori, për këtë bashkëshort ka një trajtim të diferencuar sa i përket pasojave të pavlefshmërisë duke i barazuar këto, vetëm për këtë bashkëshort, me ato të zgjidhjes së martesës, ndonëse martesë si e tillë konsiderohet që nuk është lidhur (4).
4. Gjykata do të shprehet vetëm mbi objektin e padisë. Pra, nëse ka një padi për pavlefshmëri martesë dhe verifikohen kushtet e pavlefshmërisë gjykata do e shpallë martesën të pavlefshme. Nëse nuk vërtetohet se jemi përpara një martesë të pavlefshme, atëherë gjykata nuk mund të procedojë brenda këtij procesi me zgjidhje martesë por do rrëzojë padinë e pavlefshmërisë së martesës (5).
5. Në rast se ka një kundërpadi me objekt zgjidhje martesë (psh, sipas nenit 132 të KF Zgjidhja e martesës me kërkesën e njërit bashkëshort) që kjo të pranohet të gjykohet së bashku me padinë në gjykimin e filluar, duhet të plotësojë të paktën njërin nga dy elementet substanciale të kërkuar nga neni 160 i KPC si lidhjen midis kërtimeve dhe/ose mundësinë e përmbushjes së detyrimeve të ndërsjella(5).

Jusdolo

6. Nuk duhet ngatërruar “Martesa e lidhur nga bashkëshortët pa pasur qëllim për jetë të përbashkët si burrë e grua është e pavlefshme” me nenin 55 të KF sepse i përketin dy instituteve të ndryshme. Në rastin e parë lidhet me aktin e vesuar sepse qëllimi e cenon aktin; në rastin e dytë me marrëdhënien dhe gjatë jetës ndodh për shkak objektiv të ‘sakrifikohet’ jetesa e përbashkët por kjo nuk mund të jetë shkak për pavlefshmërinë e martesë por për zgjidhjen e saj (1)



Arta Mondro

Juolaze